



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 3 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 84-të të mbajtur më 31.03.2023 ka miratuar si në vijim.

## VENDIM

Procedura sipas lëndës me numër 12 - 679/1 të datës 02.02.2023, dorëzuar KSHPK-së, por drejtuar Qeverisë së RMV-së me kërkesë që të vendoset në rend dite seanca e Qeverisë për rishqyrtimin e Vendimit për dhënien e koncesionit të ----- "-----", NDËRPRITET.

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprime të mëtejshme lidhur me këtë çështje për faktin se në rastin në fjalë kërkuesi e ka tërhequr raportin e dorëzuar.

Lënda me numër 12 - 679/1 të datës 02.02.2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Ky vendim në formë të depersonalizuar do të publikohet në faqen e internetit të KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi.

## Arsyetim

Një kërkuesi i njohur, ----- më 02.02.2023, ka dorëzuar kërkesë me të drejtë qeverisë së RMV-së për vënien në rend dite të një seancë e Qeverisë për rishqyrtimin e Vendimit për dhënien e koncesionit të ----- nga ana e "-----" për shkak të dyshimit për parregullsi në procedure.

Nga ana e parashtruesit të denoncimit në KSHPK është dorëzuar denoncim i regjistruar me numër arkivi 12 - 679/2 datë 31.10.2019, me të cilën tërhiqet denoncimi i dorëzuar në KSHPK më 02.02.2023, e cila është regjistruar në arkivin e KSHPK-së me numër 12 - 679/1.

Në seancë, pas shqyrtimit të kërkesës në fjalë, KSHPK-ja deklaroi se në rastin në fjalë kërkesa e paraqitur është tërhequr nga parashtruesi i kërkesës, pas së cilës ka vlerësuar se Komisioni Shtetëror nuk ka elemente për veprimin e mëtutjeshëm të tij dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

**КОМИСИОНИ СШТЕТЃОРОРЕ  
ПЃР ПАРАНДАЃИМИН Е КОРРУПСИОНИТ  
НЃнкрyетаре,  
Katica Nikolovska**

PЃrpiloi: J.C,  
Miratoi: Mr. V.G , anЃtar i KSHPK-sЃ

